



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 08

Prishtinë, më 14.11.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Glauk Konjufca, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Sami Kurteshi, Agim Aliu, dhe Jelena Bontiq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Gramoz Paçarada, KDI; Kaltrina Zymberi, EO; Jehona Zhuriqi, Arbresh.info; Sanije Berisha, OSBE; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Naim Jakaj, GP Vetëvendosje; Lasto Juhaz, Zsofia Czoma dhe Claudia Ribero, Projekti i Binjakëzimit.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit mbi politikat kyçe dhe sfidat legjislative që kanë të bëjnë me procesin e MSA-së;
3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të institucioneve/agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-010 për noterinë;
5. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke u hequr pika 3 e rendit të ditës.*

## 2. Diskutim me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit mbi politikat kyçe dhe sfidat legislative që kanë të bëjnë me procesin e MSA-së

**Albulena Haxhiu, kryetare,** tha se sot kemi të ftuar ekspertët e Projektit të Binjakëzimit, për të diskutuar mbi politikat kyçe dhe sfidat legislative që kanë të bëjnë me procesin e MSA-së, duke i ftuar për të marrë fjalën.

**Zsofia Czoma,** tha se shpreh kënaqësinë që jemi bashkë me ju, për të folur për rëndësinë e zbatimit të MSA-së. Po ashtu, ajo tha se kemi një projekt dyvjeçar për të mbështetur punën e Kuvendit të Kosovës dhe të stafit të Kuvendit, në veçanti, për komisionet parlamentare për çështje të integritetit që kanë të bëjnë me zbatim të procesit të MSA-së.

**Lasto Juhaz,** tha se kam përvoja personale në rastin e Hungarisë, sepse në raste të caktuara kam qenë i përfshirë në zbatim të MSA-së. Marrëveshja e MSA-së së Hungarisë, me këtë të Kosovës, ka ngjashmëri, sepse të dyja synojnë liberalizimin e tregut ndërmjet palëve kontraktuese dhe pjesëmarrje graduale në programe përkatëse të BE-së. Sa i përket MSA-së së Kosovës, është një marrëveshje speciale në kuptimin që është quajtur marrëveshje vetëm me BE-në, që do të thotë se politikat dhe fushat e ndryshme që mbulohen nga marrëveshja i takojnë ekskluzivisht politikave të Bashkimit Evropian, ku vendet anëtare të BE-së, nuk marrin pjesë në marrëveshje, si palë nënshkruese. Pra, mund të thuhet se është një marrëveshje “Suigeneris”. MSA e Kosovës ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016 dhe është një marrëveshje gjithëpërfshirëse, sepse i mbulon shumë fusha të politikave. Asocimi do të arrihet gradualisht dhe në mënyrë progresive në periudhën 10 vjeçare, që është fazë tranzicioni, që duhet të ndërmerren masat e nevojshme në fushat e ndryshme. Institucioni i dytë që punon në nivel administrativ është Komiteti për Stabilizim-Asocim, i cili mbështet punën e Këshillit. Institucioni i tretë është Komisioni Parlamentar për Stabilizim-Asocim, i cili është institucion i përbashkët mes Kuvendit të Kosovës dhe Parlamentit Evropian. Ky institucion, punon në mënyrë transparente për publikun dhe mund të miratojë rekomandime të përbashkëta për Bashkimin Evropian dhe për autoritetet e Kosovës. Gjithashtu, i kemi 7 nën- komitete që mbulojnë fusha të caktuara të Marrëveshjes së Asocimit dhe merren me analizimin dhe shqyrtimin sistematik të progresit të Kosovës në fushën transpozimit të Acquesë BE-së dhe ndërtimit të institucioneve.

**Kryetarja,** tha se nuk është funksionalizuar, deri tani, Komisionin Parlamentar për MSA-në, për faktin se opozita po e kundërshton kryesimin nga nënkryetari i Kuvendit dhe kemi kërkuar që kryesimi i këtij komisioni t'i lihet opozitës, për shkak se Qeveria e ka komision për MSA-në dhe për ne është e papranueshme, që edhe komisionin e Kuvendit ta kryesojë pozita. Pra, i njëjti kryesim të bëhet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Gjithashtu, znj. Haxhiu ngriti shqetësim se dy herë radhazi është tërhequr, pa asnjë arsyetim, në mbledhje të seancës plenare, Projektligji për parandalim dhe konflikt të interesit, duke pohuar se një nga kërkesat kryesore të MSA-së është edhe miratimi i këtij ligji, të cilin ne do ta shqyrtojmë në mbledhjen e radhës dhe do ta procedojmë për miratim, në parim, në mbledhje të seancës plenare. Komisioni për Legjislacion shqyrton dhe miraton projektligjet që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë dhe mbikëqyrë institucionet e pavarura që bien në fushëveprim të tij, por do të japim kontributin tonë edhe në

monitorimin për zbatimin e legjislacionit. Shpeshherë kemi pasur probleme në zbatim të legjislacionit, sepse nuk mund të themi që legjislacionin e kemi të keq, mirëpo shumica e ligjeve nuk po zbatohen, andaj komisioni duhet ta ketë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

**Glauk Konjufca**, tha se Kosova është në rrugë të qartë të proceseve integruese, por kemi edhe sfidat tona specifike, për shkak të kontekstit ndërkombëtar dhe procesit të shtetndërtimit të Kosovës. Mosnjohja e pesë vendeve të Bashkimit Evropian, na bën shumë pengesa në ecjen tutje të Kosovës, për t'u bërë anëtaree BE-së, me të drejta të plota. Ndonëse Kosovën e kanë njohur disa shtete, pra e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, të cilat japin kontribut të çmueshëm që ta shtrijnëndikimin e tyre, që edhe këto pesë shtete ta njohin shtetin e Kosovës. Gjithmonë, në proceset përfundimtare integruese, Kosova e ka atë dozën dyshimit se a do të përmyllet procesi me sukses, për shkak të pengesës objektive që ekziston. Me Traktatin e Lisbonës i është dhënë Kosovës një garanci shtesë se proceset mund të përmyllen me sukses, mirëpo në anën tjetër edhe ne kemi detyrat tona, që dalin nga marrëdhënia kontraktuale me Bashkimin Evropian. Kosova mund të marrë këshilla të drejtpërdrejta nga vendet që e kanë kaluar këtë proces, në mënyrë që ne të marrim përvojat e tyre, për ta pasur më të lehtë. Më tej, z. Konjufca tha se në shumicën e rasteve, projektligjet vijjnë nga Qeveria dhe shumë pak ligje hartohen nga Kuvendi, duke pohuar se Kuvendi nuk ka fonde për ekspertë, andaj kjo nuk është shenjë e mirë për një demokraci të zhvilluar, por përkundrazi tregon se është një shtet në fazën e parë të demokracisë. Andaj, është nevojshme që Kuvendi të ketë kapacitete humane, e cila është esenciale në fazën ku ndodhemi ne, në mbikëqyrjen e implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Në fund, z. Konjufca theksoi se në raport me BE-në, ne duhet të jemi të sigurtë dhe t'i themi gjërat troç.

**Hajdar Beqa**, tha se për Republikën e Kosovës është një ndër të arriturat më të rëndësishme, nënshkrimi i MSA-së, ku edhe pozita edhe opozita mendoj se duhet të kenë një qëndrim, sepse është një marrëveshje që na mundëson për t'u zhvilluar vendi, me ekonomi të qëndrueshme, tregti të lirë, po ashtu të harmonizojmë dhe përafrojmë ligjet me Bashkimin Evropian, duke marrë edhe rekomandime. Më tej, z. Beqa theksoi se ndër pikat që është shumë e rëndësishme të kryhet, është edhe Rregullorja e Kuvendit, në të cilën ju keni dhënë rekomandime, por në të njëjtën kohë, ne duhet ta kemi edhe një konsensus politik për të votuar Rregulloren e Kuvendit me 2/3 e deputetëve në Kuvend. Ne duhet t'i kryejmë detyrat tona, në fushën e sundimit të ligjit, prokurimit publik, rendit, duke konsideruar që kjo marrëveshje, sa më shpejt të implementohet në tërësi, duke pohuar se është në interes të gjithë vendit dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, z. Beqa pyeti për përvojën e shtetit hungarez, se kush e ka udhëhequr Komision për MSA-në, pozita apo opozita, edhe pse konsideron që pozita do të ishte më mirë që ta udhëheqë Komisionin për MSA-në.

**Shkumbin Demaliaj**, tha se duhet të jemi transparent dhe në nivel të duhur në lidhje me BE-në, që ne të bashkëpunojmë dhe të ecim drejt zhvillimit të Kosovës dhe në këtë rrugëtim t'ju jemi mirënjohës dhe falënderues për atë që po na ndihmoni, që ne të jemi pjesë e përbashkët e kësaj familje të madhe. Ne kemi shumë nevojë që të kemi një treg të lirë, por edhe në aspektin e sigurisë do donim që të na ndihmonit shumë, duke e ditur që edhe Hungaria ka përvojë në këtë segment, sepse është ballafaquar me vendet e Baltikut.

**Korab Sejdiu**, tha se baza e një marrëdhënie kontraktuale, është bindja e secilës palë që mund t'i përmbushë detyrimet e veta, deri në pikën e fundit, dhe në fakt, në këtë marrëdhënie kontraktuale që Kosova ka hyrë me BE-në, besoj që, deri diku, asnjëra palë nuk ka qenë 100 % e bindur se mund t'i përmbahen obligimeve që i kanë marrë përsipër. Janë disa çështje të brendshme që e parandalojnë Kosovën, si qëllim përfundimtar, anëtarësimin e saj në BE, mirëpo një reflektim nga të dyja palët do të ishte absolutisht i nevojshëm. Detyrimisht, edhe konsensusi i brendshëm, duke siguruar edhe njohjen ose një qëndrim neutral nga shtetet që s'e kanë njohur Kosovën deri tani, do të ishte një parakusht, ndërsa në anën e Kosovës, besoj se kemi shumë obligime. Përmbushja e kriterëve elementare që të funksionojmë si shoqëri, ku bashkimi ose ndërlidhja e shoqërisë sonë me atë të BE-së të jetë natyrale dhe jo artificiale, për të cilën ne mund të bartim pasojat përmes shkatërrimit të kompanive tona, sepse nuk jemi të gatshëm për liberalizim apo të dështimit, sa i përket demokracisë që te ne është shumë e reedhe me probleme, edhe me ngecje të vazhdueshme që po ndodh pas çdo palë zgjedhesh. Prandaj, ju lus që të dyja palët të punojnë në anën e tyre, që të sigurohemi t'i përmbushim kushtet, po ashtu të na ndihmoni që ne jo vetëm të kemi ligje, por edhe t'i zbatojmë ato ligje, jo detyrimisht, por ato të mishërohen me ne, si shoqëri.

*Pas takimit me përfaqësues të Binjakëzimit, anëtarët e komisionit i falënderuan për bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme, që edhe Kosova së shpejti të bëhet pjesë e familjes së madhe evropiane.*

### **3. Shqyrtimi në parimi Projektligjit nr. 06/L-010 për noterinë**

**Kryetarj**aparaqiti për shqyrtim Projektligjin për noterinë dhe theksoi se sa i përket noterisë, në përgjithësi, kemi pasur shumë probleme në të kaluarën, kur noterë të caktuar kanë lidhur marrëveshje kriminale dhe më pas janë akuzuar, arrestuar. Unë mendoj që Ministria e Drejtësisë është dashur të bëjë një mbikëqyrje të vazhdueshme të punës që po e bëjnë noterët. Sa i përket projektligjit, rregullon kushtet për ushtrimin e noterisë, provimi i noterisë, kompetencat e noterit, si dhe çështje tjera me rëndësi për ushtrimin e detyrës së noterit në territorin e Republikës së Kosovës. Shqetësim i imi është se me këtë projektligj për noterinë i është shtuar një kompetencë gjykatave dhe i është shtuar noterëve për kryerjen e të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore, por që kjo është një kompetencë shumë e rëndësishme, të cilën e kanë gjykatat dhe që po kalon te noterët. Unë mendoj se duhet të vlerësojmë tek kushtet e noterëve, se a janë të aftë të bëjnë këtë detyrë të re. Po ashtu, me vendim të ministrit, rritet numri i vendeve të noterëve dhe atë që për çdo 10000 banorë, përcaktohet nga një vend i noterit. Gjithashtu, duhet të diskutohet moshja për ushtrimin e funksionit të noterit, që në projektligj është paraparë të jetë pa kufizim, nëse nuk e ndalon neni 22, 23 dhe 24, mund të punojë edhe pas moshës 70 vjeçare. Ka edhe shumë vërejtje apo shqetësime tjera, në cilën do t'i diskutojmë në grupet punuese, që do t'i ketë. Më tej, znj. Haxhiu kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë ndonjë vërejtje.

**Arben Gashi**, tha se duhet të liberalizohet ende më shumë tregu i noterisë, që të ketë më shumë konkurrencë, në mënyrë që të bien çmimet, sepse qytetarët po paguajnë shumë dhe duhet të shihet sesi të rregullohet kjo çështje me ligj. Kemi lënë një lloj tregu të kontrolluar, duke vënë kuota për një noter, si p.sh. Ferizaj i ka gjithsej 5 noterë, ndërsa Vitia e ka një noter, pra kemi krijuar monopol ose oligopol në një territor të caktuar të kryerjes së shërbimeve. Po ashtu, duhet t'i japim përgjegjësi, kur noterët legalizojnë dokumente të paligjshme, është vepër penale. Andaj, duhet të rregullohet sistemi në tërësi, që të marrin përgjegjësi kur të vulosin një dokument dhe jo të marrin të holla dhe mos të marrin përgjegjësi.

**Korab Sejdiu**, tha se kur na është imponuar sistemi i Zvicrës për noterinë, kam qenë kundër, por atëherë nuk kam qenë në pozitë që të kisha mundësi të kundërshtoja formalisht. Kemi shumë probleme që kanë lindur, kur u miratua dhe ka hyrë në fuqi infrastruktura ligjore për noter dhe besoj që mbikëqyrja ka qenë problematike, sepse një pjesë e mbikëqyrjes ka qenë nga Ministria e Drejtësisë, ku ata nuk kanë pasur përvojë në këtë drejtim. Ndërsa, Odës së Noterëve i janë dhënë kompetenca të mëdha, sa i përket interpretimit të Ligjit për noterinë, ku ata kanë bërë interpretime në interes të atyre që kanë qenë pjesë përbërëse të Odës së Noterëve. Z. Sejdiu theksoi se për t'u bërë ndryshime që t'i mbrojmë qytetarët duhet të vëmë një kufi tek tarifat që mund të imponohen në transaksione të ndryshme, duke i bërë pjesë të ligjit. Në fund, z. Sejdiu tha se sistemi aktual është i paqëndrueshëm për dy arsye: çmimi astronomik dhe mungesa e mbikëqyrjes, e cila ka qenë e njëanshme.

**Hajdar Beqa**, tha se në parim i plotëson kushte që ne ta miratojmë këtë projektligj dhe gjatë fazës së amendamentimit, ne mund t'i adresojmë sugjerimet dhe vërejtjet tona. Mendoj që është mirë tërritet numri i vendeve të noterëve dhe atë që për çdo 10000 banorë, sepse e rrit edhe konkurrencën e tregut.

**Arben Gashi**, tha se është shumë e rëndësishme që ligji ka ardhur në rishikim dhe të miratohet në parim në komision dhe më pas të merremi me problemet reale që ka sistemi. Po ashtu, të mbrojmë maksimalisht interesin publik, duke e rregulluar me ligj. Pra, unë jam i idesë së liberalizimit të tregut dhe funksionalizimit dhe institucionalizimit të kontrollit të noterëve dhe përgjegjshmërisë së tyre.

*Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me shumicë votash, (6 përdhe 2 kundër), vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-010 për noterinë.

#### **4. Të ndryshme**

*Në këtë pikë u diskutua dhe u vendos nga anëtarët komisionit që, mbledhjet e komisionit, të mbahen ditën e martë të javës, në orën 13:00.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**